

FJALA E DEPUTETES ERMONELA FELAJ

E ENJTE 7 KORRIK 2022

Të nderuar kolegë,

Kur flitet për veprimtarinë e Komisionit të Prokurimit Publik, sigurisht është e pashmangshme të mos e lidhësh atë me korrupsionin, sepse vetë ligji e ka përcaktuar Komisionin e Prokurimit Publik si një ndër hallkat që, me punën e vet dhe me përpjekjet e veta, duhet të shërbejë në funksion të parandalimit të korrupsionit, në nivelin e funksionarëve publikë dhe në atë që lidhet me të ashtuquajturat kontrata publike. Kështu që, është e paevitueshme kjo pjesë, por ama duhet të ndajmë secilin prej instrumenteve që ligji vendos në luftën kundër korrupsionit dhe përgjegjësitë e tyre, ku gjithçkaje dhe secilit t'i vëmë emrin që meriton. Komisionit të Prokurimit Publik nga Bashkimi Europian i është vendosur si detyrë që të digjitalizojë komplet procesin e ankimimeve.

Kjo është një gjë që ka ndodhur, është një detyrë e kryer tanimë dhe realisht i vlen punës dhe veprimtarisë së këtij institucioni, sepse do të thotë që i gjithë procesi i ankimimeve kryhet me transparencë. Në kohë reale të tria organet kryesore që marrin pjesë ose që lidhen në një proces prokurimi, autoriteti kontraktor, operatorët ekonomikë dhe Komisioni i Prokurimit Publik marrin vesh për ankimin. Komisioni i Prokurimit Publik ka mundësi, po ashtu, duke shfrytëzuar digjitalizimin, të japë përgjigjen në kohë reale dhe online. Vetëm pak kohë më parë, jo më larg se viti 2019, 40% e ankesave, që lidheshin me prokurimet publike, ishin jashtë afatit. Pra, i gjithë digjitalizimi i shërben mundësisë së dhënies së përgjigjes në kohë, i shërben faktit që të mos kemi shqyrtime të ankimimeve, që dalin jashtë afatit, dhe kjo është diçka që duhet vlerësuar.

Ajo për të cilën unë doja të tërhiqja vëmendjen, është që ne duhet të kemi një qasje më komplementare, por këtu ndodh rëndom që njerëzit vijnë pa lexuar, me qëndrime të paracaktuara dhe nuk u intereson fare si lidhet kjo punë me punën e institucioneve të tjera. Për shembull, në Kuvendin e Shqipërisë nuk dëgjohet Agjencia e Prokurimit Publik dhe në këtë

dëgjesë nuk marrin pjesë kolegë të Komisionit të Ekonomisë. Unë do të kisha propozuar që kjo dëgjesë të ishte e përbashkët. Komisioni i Prokurimit Publik duhet të dëgjohej së bashku me Agjencinë e Prokurimit Publik, ndonëse njëri është person juridik, publik i pavarur dhe tjetri është person juridik, që është në varësi të Kryeministrit. Nëse duam të kuptojmë, duhet të shkojmë më shumë sesa raporti i Bashkimit Europian, më shumë se sa raporti i SIGMA-s, më shumë sesa vlerësimi që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe të Dhënat Personale bën për Komisionin e Prokurimit Publik.

Në të tria këto raste që unë referova, Komisioneri i Prokurimit Publik vlerësohet pozitivisht, vlerësohet shumë mirë. Nëse vërtet ne duam të kuptojmë se çfarë duhet të bëjmë akoma më shumë, sesi duhet ta rrisim përgjegjësinë e këtij institucioni në luftën kundër korrupsionit, si një ndër hallkat e atij zinxhiri, që jemi përpjekur gjithë këto vite të vëmë në funksionim për të luftuar korrupsionin, atëherë, sigurisht, duhet të shohim më shumë se një raport. Unë do ta ftoja, në fakt, Komisionerin ta rrisë proaktivitetin e vet dhe kjo të shkojë jo vetëm në drejtim të digjitalizimit të shërbimeve dhe të gjithçka tjetër, arshivës, që është e nevojshme për të kuptuar punën që bëhet në institucionin e Komisionerit Publik, por të shohë edhe raporte të tjera, raporte të cilat tregojnë, flasin për korrupsionin, ngrenë shqetësime për korrupsionin dhe të mund të shkëpusë nga ato raporte atë që lidhet me veprimtarinë e vet.

E bëra këtë ndërhyrje jo vetëm se ligji e vendos në të njëjtin vend edhe Komisionerin e Prokurimit Publik, edhe Agjencinë e Prokurimit Publik, është i njëjti ligj që flet për të dyja këto institucione. Agjencia e Prokurimit Publik nuk është më pak e rëndësishme, sepse mbikëqyr procesin e prokurimeve publike. Nga ana tjetër, ligji i ka dhënë dhe një detyrë Agjencisë së Prokurimit Publik, të ndërhyjë me propozime për ndryshime ligjore dhe në më se një rast, edhe në Komisionin e Ligjeve, por edhe gjatë ditës së sotme, në diskutimet që u mbajtën për këtë raport, u fol edhe për mundësinë e ndryshimeve të tjera ligjore, ndonëse ligji për herë të fundit është ndryshuar në vitin 2020 dhe këto ndryshime janë vlerësuar si pozitive.

Korrupsioni nuk mund të jetë një konstante e jetës politike dhe e jetës shoqërore, por kjo do të ndodhë nëse ne do të jemi të vërtetë në të gjithë përpjekjen që bëjmë dhe nuk sillemi thjesht dhe vetëm me shqetësimin për të shënuar një rekord të foluri në Kuvendin e Shqipërisë, pa

ofruar asnjë lloj sugjerimi sesi punët mund të çohen më mirë më tej, pa i përfshirë të gjithë në të njëjtin vlerësim, sepse sigurisht ka njerëz që përpiqen, ka njerëz që punojnë, por ka edhe njerëz që nuk bëjnë të njëjtën gjë, dhe na takon neve ta bëjmë këtë diferencë përmes të qenit seriozë. Kështu që, unë për këtë do t'ju ftoja kolegë dhe, njëkohësisht, do të falënderoja Komisionerin, që qëndroi gjatë gjithë kohës për të dëgjuar debatin tonë, në funksion të veprimtarisë, për të cilën ai është zgjedhur të kryejë nga Kuvendi i Shqipërisë. Faleminderit!